

# PHILIPS

Boks me valë

Seria 2000

TAS2307



## Manuali i përdoruesit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në:  
[www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)

# Përmbajtja

---

<b>1 Të rëndësishme</b>	<b>2</b>
Siguria	2

---

<b>2 Boksi juaj me valë</b>	<b>3</b>
Çfarë ka në kuti	3
Përmbledhje e boksit	3

---

<b>3 Fillimi</b>	<b>4</b>
Karikoni baterinë e brendshme	4
Ndezja/fikja	4

---

<b>4 Luajtja nga pajisjet me Bluetooth</b>	<b>5</b>
Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	5

---

<b>5 Informacione për produktin</b>	<b>6</b>
-------------------------------------	----------

---

<b>6 Zgjidhja e problemeve</b>	<b>6</b>
Të përgjithshme	6
Bluetooth	7

---

<b>7 Njoftim</b>	<b>7</b>
Pajtueshmëria	7
Kujdesi për mjedisin	7
Deklarata FCC dhe IC	8
Trademark notice	9

# 1 Të rëndësishme

## Siguria

### Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë njësisë.
- Boksi nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vendosni asnjë burim rreziku mbi boks (p.sh. objekte të mbushura me lëngje, qirinjtë të ndezur).
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë boksit për ajrim.
- Ju lutemi përdorni boksën në mënyrë të sigurt në një ambient me temperaturë ndërmjet 0 °C dhe 40 °C.
- Përdorni vetëm pjesë dhe aksesore të specifikuar nga prodhuesi.

### Masa paraprake për baterinë

- Rrezik shpërthimi nëse bateria nuk vendoset si duhet. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Bateria (paketa e baterisë ose bateria e instaluar) nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësisë së larë, si për shembull drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Nëse bateria përdoret, ruhet ose transportohet në temperatura tepër të larta ose tepër të ulëta, dhe në presion atmosferik tepër të ulët në lartësi të mëdha mund të përbëjë rrezik.
- Mos e ndërroni baterinë me një tip të gabuar që mund të shkelë një masë sigurie (për shembull, disa lloje baterish litiumi).

- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë, ose shtypja apo prerja mekanikisht e baterisë mund të shkaktojë shpërthim.
- Lënia e baterisë në një ambient me temperaturë tepër të lartë, ose në një ambient me presion atmosferik tepër të ulët mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngjeve ose gazrave të djegshëm.



### Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boksi.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij boksi.
- Vendoseni boksën mbi sipërfaqe të sheshtë, të fortë dhe të qëndrueshme.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë boks mbi pajisje të tjera elektrike.
- Përdorni boksën vetëm brenda. Mbajeni boksën larg nga uji, lagështia dhe objektet e mbushura me lëngje.
- Mbajeni boksën larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria ndërrohet me një tip të gabuar.
- Mbani parasysh se pajisja përmban bateri litiumi. Kapaciteti i karikimit të baterive të litiumit bie me kalimin e kohës për shkak të vetive të tyre të vetshkarkimit. Për të garantuar jetëgjatësinë e baterisë së pajisjes, rekomandojmë që **ta karikoni baterinë e brendshme prej litiumi në nivelin rreth 50% çdo 6 muaj kur pajisja nuk përdoret.**

## 2 Boksi juaj me valë


Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).






### Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Boksi (rrip i përfshirë)
- Kabllo USB
- Manuali i përdorimit
- Dokumenti i sigurisë
- Garancia mbarëbotërore

### Përmbledhje e boksit



- ①  Ndizeni ose fikeni boksën
- ②  Shtypje e shkurtër: Volumi ulet një nivel  
Shtypje e gjatë: Uleni vazhdimisht volumin
- ③  Shtypje e shkurtër: Ndaloni ose vazhdoni luajtjen  
Shtypje e gjatë: Hyni në modalitetin e çiftimit / shkëputni pajisjen e çiftuar për të hyrë në modalitetin e çiftimit  
Shtypje e shpejtë dy herë: Kaloni te kënga tjetër  
Shtypje e shpejtë tri herë: Kaloni te kënga e mëparshme
- ④  Shtypje e shkurtër: Volumi rritet një nivel  
Shtypje e gjatë: Volumi rritet vazhdimisht
- ⑤  Shtypje e shkurtër: Modaliteti i dritës  
Shtypje e gjatë: Ndizeni ose fikni dritën
- ⑥ **DC IN**  
Karikoni baterinë e brendshme
- ⑦ **Treguesi LED**  
Shfaqni gjendjen e karikimit të baterisë

# 3 Fillimi

Ndiqni gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


## Karikoni baterinë e brendshme

Boksi merr energjinë nga një bateri e brendshme karikueshme.

### Shënim

- Karikoni plotësisht baterinë e brendshme para se ta përdorni.

Lidhni kabllon USB-C në boks me një prizë (5 V = 1 A) duke përdorur kabllon USB të dhënë.




- ↳ Kur boksi është duke u karikuar, treguesi LED ndizet në ngjyrë të bardhë.
- ↳ Kur boksi është i karikuar plotësisht, treguesi LED fiket.


### Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të boksit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që është printuar mbrapa ose poshtë boksit.
- Rrezik goditjeje elektrike! Kur hiqni kabllon USB, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza. Mos tërhiqni asnjëherë kabllon.
- Përdorni vetëm kablo USB të specifikuar nga prodhuesi ose që shitet bashkë me këtë boks.

## Ndezja/fikja

Shtypni  për ta ndezur boksën.

- ↳ Do të dëgjoni tingullin lajmërues.

Për ta fikur boksën, shtypni  përsëri.

- ↳ Do të dëgjoni tingullin lajmërues.

### Shënim

- Boksi do të fiket automatikisht nëse nuk ka sinjal audio nga Bluetooth për 15 minuta.

# 4 Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

## Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

Me këtë boks mund të dëgjoni audio nga pajisja juaj me Bluetooth.

### Shënim

- Sigurohuni që funksioni i Bluetooth është aktivizuar në pajisjen tuaj.
- Distanca maksimale për çiftimin e boksit dhe pajisjes me Bluetooth është 20 metra.
- Mbajeni larg nga çdo pajisje elektronike që mund të shkaktojë interferenca.

1. Ndizeni boksën, dhe boksë do të hyjë automatikisht në modalitetin e Bluetooth me dritë pulsuese të bardhë. Gjithashtu mund të shtypni dhe mbani shtypur ►► për 3 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit.
2. Aktivizoni Bluetooth dhe zgjidhni "Philips S2307" në listën e Bluetooth në pajisjen tuaj për çiftim.
3. Luani audio në pajisjen tuaj me Bluetooth për të filluar transmetimin e muzikës.

### Gjatë luajtjes së muzikës

- Shtypeni për të ndaluar ose vazhduar luajtjen
- Shtypeni dy herë për të luajtur këngën tjetër
- Tri herë për të luajtur këngën e mëparshme

— / + Rregulloni volumnin

### Kontrolloni efektin e dritës

Me Bluetooth të lidhur me sukses, mund të shtypni shkurtimisht ✨ për të ndryshuar modalitetin e dritës midis simfoni, pulsime shumëngjyrësh dhe pulsime të bardhë. Ose mbani shtypur ✨ për ta ndezur ose fikur dritën.

Efektin e dritës	Statusi i Bluetooth
Dritë e bardhë	Gati për çiftim
Dritë e bardhë	Duke u lidhur përsëri me pajisjen e lidhur për herë të fundit
Dritë shumëngjyrëshe	Lidhur

### Shënim

Për ta shkëputur pajisjen, mund të

- Shtypni dhe mbani shtypur ►► derisa të shihni dritën e bardhë pulsuese; ose
- Te pajisja e lidhur, zgjidhni emrin e çiftimit "Philips S2307" në listën e pajisjeve me Bluetooth dhe klikoni për të anuluar çiftimin. Pasi të jetë shkëputur, do të shihni dritën e bardhë pulsuese.

## 5 Informacione për produktin

### Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

### Informacione të përgjithshme

Porta USB	5 V $\equiv$ 1 A
Bateri e brendshme litiumi	1500 mAh
Përmasat (Gje x La x The)	103,3 x 46,6 x 88 mm
Pesha (njësia kryesore)	200 g $\pm$ 5 g
Ambienti i operimit	0 °C ~ 40 °C

### Amplifikatori

Fuqia output (RMS)	5 W
Përgjigja e frekuencës	160 Hz - 18 kHz
Raporti sinjal-zhurmë	>70 dB

### Boksi

Impedanca	4 $\Omega$
Fuqia maksimale input	5 W
Drajveri	Diametri 45 mm
Radiatorë pasivë	1

### Bluetooth

Versioni i Bluetooth	5.3
Rrezja e frekuencave	2402 - 2480 MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	<10 dBm
Profilat e pajtueshme të Bluetooth	Mbështet a2dp/avctp/avrcp/hfp
Rrezja e Bluetooth	deri në 20 m

## 6 Zgjidhja e problemeve

### Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij boksi.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni boksën vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni boksën, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips ([www.philips.com/support](http://www.philips.com/support)). Kur kontakti Philips, sigurohuni që boksi është pranë dhe që numri i modelit dhe numri i serisë të jetë i disponueshëm.

### Të përgjithshme

#### Nuk ndizet

- Sigurohuni që boksi është i karikuar plotësisht.
- Sigurohuni që priza USB e boksit është lidhur si duhet.
- Si veçori e kursimit të energjisë, boksi fiket vetë pas 15 minutash nëse nuk merret sinjal audio.

#### Nuk ka zë

- Ngrini volumnin në këtë boks.
- Ngrini volumnin në pajisjen e lidhur.
- Sigurohuni që pajisja me Bluetooth nuk është tepër larg.

#### Nuk ka përgjigje nga boksi

- Ndizeni përsëri boksën.


---

## Bluetooth

Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth

- Sinjali i Bluetooth është i dobët.  
Afrojeni më shumë boksen ose hiqni çdo pengesë mes tyre.

Nuk gjendet [Philips S2307] në pajisjen tuaj me Bluetooth për çiftim

- Shtypni dhe mbani shtypur  për 3 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit me Bluetooth, dhe më pas provoni përsëri.

Nuk mund ta lidhni pajisjen tuaj me Bluetooth

- Funkzioni i Bluetooth i pajisjes suaj nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të mësuar se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky boks nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky boks është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni dhe provoni përsëri.

## 7 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga MMD Hong Kong Holding Limited mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

---

## Pajtueshmëria



Këtu, TP Vision Europe B.V. deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të direktivës Directive 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në [www.philips.com/support](http://www.philips.com/support).

---

## Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga European Directive 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga European Directive 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake.



Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

### Heqja e baterive të brendshme

Sigurohuni që produkti është i shkëputur nga energjia para se të hiqni baterinë e brendshme.



Vetëm për qëllime ilustrimi

### Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistiroli (amortizuesi) dhe polietilien (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë, ose shtypja apo prerja mekanikisht e baterisë mund të shkaktojë shpërthim.

## Deklarata FCC dhe IC

### Informacione të FCC

Pajisja është në përputhje me rregullat e FCC, pjesa 15. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

- ① Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme, dhe
- ② Kjo pajisje duhet të pranojë çdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktohen nga punimi i padëshiruar.

**Paralajmërim:** Ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për ta përdorur pajisjen.

**Shënim:** Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Klasit B, sipas pikës 15 të rregullave FCC.

Këto limite janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi.

Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas udhëzimeve, mund të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj komunikimeve radio. Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferenca në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferenca të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe nderur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme: (1) Ndryshoni orientimin ose lëvizeni antenën. (2) Largoni distancën mes pajisjes dhe marrësit. (3) Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi.

(4) Flisni me shitësin ose një me teknik radioje/televizori me eksperiencë për ndihmë.

#### **Deklaratë paralajmërimi për RF**

Është vlerësuar se kjo pajisje përmbush kërkesat e përgjithshme për ekspozimin ndaj RF. Pajisja mund të përdoret në kushte ekspozimi portativ pa kufizime.

#### **IC-Canada: CAN ICES-003(B)/ NMB-003(B)**

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk mund të shkaktojë interferenca.
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interference, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

#### **Avis d'Industrie Canada: CAN ICES-003(B)/NMB-003(B)**

L'émetteur/récepteur exempt de licence contenu dans le présent appareil est conforme aux CNR d'Innovation, Sciences et Développement économique Canada applicables aux appareils radio exempts de licence. L'exploitation est autorisée aux deux conditions suivantes :

1. L'appareil ne doit pas produire de brouillage;
2. L'appareil doit accepter tout brouillage radioélectrique subi, même si le brouillage est susceptible d'en compromettre le fonctionnement.

---

## **Trademark notice**



The Bluetooth® word mark and logos are registered trademarks owned by the Bluetooth SIG, Inc. and any use of such marks by MMD Hong Kong Holding Limited is under license.

Other trademarks and trade names are those of their respective owners.



Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë.

Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

TAS2307\_00\_UM\_V1.0

